



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ___/___/ 2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 30.12.2020

Për: Operatorin ekonomik “Power Industries” Sh.P.K me NIPT L51706022H,

Adresa: : “Njësia Nr. 7, Bulevardi Gjergj Fishta, Qendra Alpas, Shkalla 2, Kati i 5, Apartamenti 14, T
Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: Referuar Urdhërit të Prokurimit Nr.33 datë 19.11.2020 me objekt: “Blerje shirita plastikë me numurator për thasë”, me fond limit total 4.005.000 (katër milion e pesë mijë) Lekë pa T.V.SH., vënë në dispozicion nga të ardhurat e vetë Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a. me procedurë “Kwerkeswe pwer Propozim” në mënyrë elektronike, e cila u zhvillua më datë 14.12.2020, ora 10.00.
[Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-79292-11-19-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje shirita plastikë me numurator për thasë”.

Fondi Limit: 4.005.000 (katër milion e pesë mijë) Lekë pa T.V.SH.

Burimi i financimit: Financuar nga të ardhurat e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 14.12.2020, ora 10.00

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Datë 23.11.2020 [Numri]
105

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofërtues me ofertën ekonomike si më poshtë vijon:

1. Operatori ekonomik “Power Industries” Shpk NIPT L51706022H me vlerë të ofertës 3.888.000 (tre milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) Lekë pa T.V.SH.

2. Operatori ekonomik “**A.K. M**” **Albanian Investment Shpk** L72230026K me vlerë të ofertës 3.570.000 (tre milion e pesëqind e shtatëdhjetë mijë) Lekë pa T.V.SH.
3. Operatori ekonomik “**Alen CO**” **Nipt K83213401M Shpk** me vlerë të ofertës 2.880.000 (dy milion e tetëqind e tetëdhjetë) Lekë pa T.V.SH. nuk është paraqitur fizikisht për të dorëzuar mostrat.

Janwe skualifikuar ofertuesi e mëposhtëm:

1. “**A.K. M**” **Albanian Investment L72230026K**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në lidhje me kriterin e parashikuar në pikën 2. gërma “a” e DST,:

- ❖ Ofertuesi duhet të dorëzojë: Formularin e ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurëve të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);

Nga verifikimi dokumentacionit të dorëzuar elektronikisht në sistemin e APP, konkretisht dokumentit “Formular Oferte”, rezulton se në ofertën e paraqitur, në përlllogaritjen e cmimit total të ofertës OE ka përlllogaritur gabim “Cmimin Total”, të dal nga rezultati i sasisë me cmimin për njësi. Konkretisht sasia prej 300.000 copë shirita e shumëzuar me vlerën 11.9 të përcaktuar në ofertë është e barabartë me 3.570.000 Lekë, ndërkohë që vlera e pasqyruar në tabel nga OE në rubrikën “Cmimi Total” është në vlerën 3,420,000.

Nga përlllogaritja e marzhit të gabimit të bërë nga OE, Komisionin konstaton se gabimi aritmetik i bërë nga OE është në masën **4.2%** të vlerës totale të ofertës ekonomike, për rrjedhim nuk jemi përpara rastit kur OE duhet ti jepej mundësia për të bërë sqarimet në lidhje me gabimin aritmetik në formularin e ofertës.

Në kushtet e mësipërme Komisioni i Vlerësimit të ofertave vlerëson se OE **A.K. M**” **Albanian Investment**, **nuk ka paraqitur ofertë të rregulltë ekonomike**, fakt që përbën shkak për skualifikimin e këtij operatori.

Në lidhje me kriterin 2.3.2

- ❖ Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 të vlefshme mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente sipas objektit të prokurimit e lëshuar nga organizimat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për përmbushjen e këtij kriteri OE ka depozituar në sistemin e APP-së një dokument EN ISO 9001:2015.

Certifikata e mësipërme është e lëshuar nga AQScert shpk i cili është organ i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, por certifikta që disponon OE, në kundërshtim me kriterin e mësipërm, nuk e përfshin objektin e prokurimit të kësaj procedure.

Konkretisht në Certifikatën e paraqitur nga OE, në pjesën e objektit shkruhet: *Importi dhe eksporti i materialeve industrialeve (materiale hidraulike/produkte te furnizimit me uje) mjete pune, makineri, pajisje laboratorike, pajisje pastrimi.*

Nga analizimi i pasazhit të mësipërm, rezulton se certifikata ISO e hedhur ne sistem nga OE, nuk e permbush kriterin e parashikuar ne DST per shkak se nuk e ka te perfshire objektin e procedures se prokurimit.

2. “Alen CO” NIPT K83213401M

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- ❖ **Nuk është paraqitur fizikisht për të dorëzuar mostrat,** në këto kushte, duke qënë se në ditën dhe në orën e caktuar për dorëzimin e mostrave, nuk është paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor, bazuar në pikën 2.3.6 të DST, Komisioni i Vlerësimit të ofertave vendosi skualifikimin e këtij operatori.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “**Power Industries**” sh.p.k. NIPT L51706022H , me adresë: “Njësia Nr. 7, Bulevardi Gjergj Fishta, Qendra Alpas, Shkalla 2, Kati i 5, Apartamenti 14, Tiranë”, se Oferta Ekonomike me vlerë 3.888.000 (tre milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) Lekë pa T.V.SH. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Posta Shqiptare Sh.a. me adresë: Rr.: “Reshit Collaku”, Nr.4, Tiranë, Drejtoria Juridike, Sektori i Prokurimeve, kati II [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] kopjet e sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kjo procedurë prokurimi anulohet pasi nuk ka operator ekonomik të klasifikuar vijues siç parashikohet në nenet 24 dhe 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.12.2020.

Ankesa: Nuk ka.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Laert Duraj